



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
TIRANË

NR. AKTI 2608
NR. 2608 AKTI
Dt. 20.05.2021 regj.

NR. VENDIMI 1777
NR. 1777 VENDIMI
Dt. 16.06.2021

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, me trup gjykues te perbere nga:

GJYQTARI KRESHNIK OMARI

asistuar nga sekretare gjyqesore Etleva Avdia dhe me pjesemarrjen e prokurores Anila Galanxhi Pappa, sot ne Tirane, me 16.06.2021, mori ne shqyrtim çeshtjen penale qe i perket:

I PANDEHUR :

1. Mario Roshi, i identifikuar me pasaporten me nr.J40822065wW, i biri i Kujtim dhe Emine, i dtl. 22.08.1994, lindur dhe banues ne Tirane, Lagjia Ali Demi, Rr. “Nazmi Rushiti”, banese private nr.17, beqar, me arsim te mesem, i padenuar me pare, i mbrojtur nga av. Shpetim Kurti.

AKUZUAR :

Per vepren penale “Mbajtja e lokaleve per prostitucion”, te parashikuar nga neni 115 i K.Penal.

2. Denada Norja, e identifikuar me leternjoftimin me nr. J16218063A, e bija e Pellumb dhe Drita, e dtl. 18.12.1994, lindur ne Kuçove dhe banuese ne Tirane, Astir, Rr. “Aleksandri i Madh”, pallati qe ndodhet siper Bar Unik, kati trete, e martuar, me 1 femije, me arsim te larte, e padenuar me pare, e mbrojtur nga av. Bardhi Koçi.

3. Xhesika Shahu, e bija e Gezim dhe e Lima, e dtl. 16.07.2001, lindur dhe banuese ne Tirane, Yzberisht, pallati perballe Spitalit Amerikan 3, kati 3-te, e martuar, me arsim te larte, e padenuar me pare, e perfaqesuar me prokure te posaçme nga av. Viola Milaqi.

4. Adriana Lika, e identifikuar me leternjoftimin me nr. J95818027F, e bija e Kudret dhe Naile, e dtl. 18.08.1999, lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, Porcelan, pallati

Gotech, kati 3-te, dera nr.14, beqare, me arsim te mesem, e padenuar me pare, e mbrojtur nga av. Bardhi Koçi.

5. Xhuliana Sharka, e identifikuar me leternjoftimin me nr. K15117017L, e bija e Hamit dhe Arta, e dtl. 17.01.2001, lindur ne Greqi dhe banuese ne Tirane, Liqeni i Thate, pallati ngjitur me Star Market, me nr. celular 0688179564, beqare, me arsim te mesem, e padenuar me pare, e mbrojtur nga av. Viola Milaqi.

AKUZUAR :

Per vepren penale te “Prostitucionit”, te parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal.

6. Stelina Kuqi, e identifikuar me leternjoftimin me nr. J95109065U, e bija e Hazbi dhe Esma, e dtl. 09.01.1999, lindur ne Kavaje dhe banuese ne Tirane, Rr. “Durrësit”, pallati pas gjimnazit Qemal Stafa, kati 4-et, beqare, me arsim te larte, e padenuar me pare, e mbrojtur nga av. Shpetim Kurti.

AKUZUAR :

Per vepren penale te “Moskallezim i krimi”, te parashikuar nga neni 300 i K.Penal.

PERSONA NE HETIM:

1.Mario Roshi, i identifikuar me pasaporten me nr.J40822065wW, i biri i Kujtim dhe Emine, i dtl. 22.08.1994, lindur dhe banues ne Tirane, Lagjia Ali Demi, Rr. “Nazmi Rushiti”, banese private nr.17, beqar, me arsim te mesem, i padenuar me pare, i mbrojtur nga av. Shpetim Kurti, i hetuar per vepren penale te “Shfrytezimi i prostitucionit” te parashikuar nga neni 114 i K.Penal.

2. Andi Roshi, i identifikuar me leternjoftimin me nr. J10424067K, i biri i Kujtim dhe Emine, i dtl. 24.04.1991, lindur dhe banues ne Tirane, Lagjia Ali Demi, Rr. “Nazmi Rushiti”, banese private nr.17, beqar, me arsim te mesem, i padenuar me pare, i mbrojtur nga av. Shpetim Kurti, i hetuar per vepren penale te “Mbajtja e lokaleve per prostitucion” te parashikuar nga neni 115 i K.Penal.

Gjykata, pasi pranoi kerkesen e te pandehurve Mario Roshi, Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika, Xhuliana Sharka dhe Stelina Kuqi per gjykim te shkurtuar dhe ne perfundim degjoi prokuroren qe kerkoi:

Deklarimin fajtor te te pandehurit Mario Roshi, per vepren penale te “Mbajtja e lokaleve per prostitucion”, te parashikuar nga neni 115 i K.Penal dhe denimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e te pandehurit me 1 vit burgim burgim.

Deklarimin fajtores te te pandehures Denada Norja, per vepren penale te "Prostitucionit", te parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal dhe denimin e saj me 6 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e te pandehures me 4 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 59 te K.Penal pezullimin e denimit me burgim per te pandehuren Denada Norja, per nje periudhe kohe prej 8 muajsh me kusht qe te mbaje kontakte me Sherbimin e Proves dhe te vihet ne prove.

Deklarimin fajtores te te pandehures Xhesika Shahu, per vepren penale te "Prostitucionit", te parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal dhe denimin e saj me 6 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e te pandehures me 4 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 59 te K.Penal pezullimin e denimit me burgim per te pandehuren Xhesika Shahu, per nje periudhe kohe prej 8 muajsh me kusht qe te mbaje kontakte me Sherbimin e Proves dhe te vihet ne prove.

Deklarimin fajtores te te pandehures Adriana Lika, per vepren penale te "Prostitucionit", te parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal dhe denimin e saj me 6 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e te pandehures me 4 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 59 te K.Penal pezullimin e denimit me burgim per te pandehuren Adriana Lika, per nje periudhe kohe prej 8 muajsh me kusht qe te mbaje kontakte me Sherbimin e Proves dhe te vihet ne prove.

Deklarimin fajtores te te pandehures Xhuliana Sharka, per vepren penale te "Prostitucionit", te parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal dhe denimin e saj me 6 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e te pandehures me 4 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 59 te K.Penal pezullimin e denimit me burgim per te pandehuren Xhuliana Sharka, per nje periudhe kohe prej 8 muajsh me kusht qe te mbaje kontakte me Sherbimin e Proves dhe te vihet ne prove.

Deklarimin fajtores te te pandehures Stelina Kuqi, per vepren penale te "Moskallezim krimi", te parashikuar nga neni 300 i K.Penal dhe denimin e saj me 6 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e te pandehures me 4 muaj burgim. Ne aplikim te nenit 59 te K.Penal pezullimin e denimit me burgim per te pandehuren Stelina Kuqi, per nje periudhe kohe prej 8 muajsh me kusht qe te mbaje kontakte me Sherbimin e Proves dhe te vihet ne prove.

Shpenzimet gjyqesore t'i ngarkohen te pandehurve.

Si edhe pasi degjoi avokatin e te pandehurit Mario Roshi, i cili kerkoi denimin e te pandehurit me kohen e paraburgimit.

Si edhe pasi degjoit avokatet te pandehurave Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika, Xhuliana Sharka dhe Stelina Kuqi qe kerkuan qe te aplikojeh neni 63 i K.Penal, duke pezulluar gjykata ekzekutimin te denimit dhe kryerjen e punes ne interes publik

V E R E N

Se Prokuroria i eshte drejtuar Gjykates me kerkesen Nr. 1478 Akti, date 20.05.2021 regjistrimi me objekt: Dergimin ne gjyq te ceshtjes penale ne ngarkim te te pandehurit Mario Koshi, i akuzuar per kryerjen e vepres penale te "Mbajtja e lokaleve per prostitucion", parashikuar nga neni 115 i K.Penal; te te pandehurave Denada Norja, Xhesika Shahu, Albiona Toska, Adriana Lika, Xhuliana Sharka, te akuzuara per vepren penale te

“Prostitucion” te parashikuar nga neni 113/1 te K.Penal; te pandehures Stelina Kuqi per vepren penale te “Moskallezim krimi” te parashikuar nga neni 300 te K.Penal; pushimin e hetimeve te procedimit penal nr. 5718, viti 2020 per vepren penale te “Mbajtjes te lokaleve pe prostitucion” te parashikuar nga neni 115 i K.Penal ne ngarkim te shtetasit Andi Roshi; pushimin e hetimeve te procedimit penal nr. 5718, viti 2020 per vepren penale te “Shfrytezimit te prostitucionit” te parashikuar nga neni 114 i K.Penal ne ngarkim te shtetasit Mario Roshi, duke i bashkelidhur kerkeses edhe aktet dhe provat qe permban fashikulli perkates. Aktet e mesiperme, rezulton se i jane komunikuar te pandehurve.

Te pandehurit Mario Roshi, Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika, Xhuliana Sharka dhe Stelina Kuqi, ne seancen paraprake, asistuar edhe nga avokatet e tyre, kerkuan gjykim te shkurtuar.

Gjykata pasi degjoi prokuroren dhe avokatet dhe pasi cmoi se ceshtja mund te zgjidhet ne gjendjen qe jane aktet vendosi te pranoje kerkesen e avokateve dhe te pandehurve Mario Roshi, Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika, Xhuliana Sharka, Stelina Kuqi per te proceduar ne kete ceshtje me gjykim te shkurtuar dhe te vecoje ceshtjen e te pandehurve Mario Roshi, Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika, Xhuliana Sharka, Stelina Kuqi nga e pandehura tjeter Albiona Toska, per te cilen gjykata vendosi gjykimin ne mungese.

Nga aktet e ndodhura ne fashikullin e gjykimit rezulton se ne date 12.09.2020 ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Tirane mbi bazen e akteve te ardhura nga Drejtoria Vendore Policise Tirane eshte regjistruar procedimi penal nr. 5718 per veprat penale “Prostitucioni”, “Shfrytezimi i Prostitucionit” dhe “Mbajtja e lokaleve per prostitucion” parashikuar nga nenet 113, 114 dhe 115 i K.Penal.

Nga hetimet e zhvilluara per kete procedim ka rezultuar se Drejtoria Vendore e Policise Tirane ka siguruar informacione ne rruge operative ne lidhje me aktivitet te paligjshem ne drejtim te “Prostitucionit”, “Shfrytezimit te prostitucionit” dhe “Mbajtjes se lokaleve per prostitucion”. Nga te dhenat e administruara dyshohet se persona qe posedojne qendra masazhi, i kane pershtatur keto ambiente per prostitucion, duke punesuar femra te ndryshme te cilat krahas punes si masazhatore, nxiten ose ju ofrohet nga pronaret dhe administratoret e ketyre aktiviteteve qe te kryejne maredhenie seksuale kundrejt pageses me klientet qe frekuentojne keto ambiente.

Me qellim parandalimin dhe goditjen e kesaj veprimtarie nga ana D.V.P. Tirane ne date 01.09.2020 eshte hartuar plani i masave me nr.prot. 365/B, duke bashkepunuar me Inspektoriatin Shteteror te Punes Sherbimeve Shoqerore. Ne date 11.09.2020 rreth ores 19:30’ ne zbatim te ketij plani masash eshte shkuar nga ana e policise gjyqesore sebashku me inspektoret e I.SH.P.SH.SH, ne dy qendra masazhi dhe konretisht ne qendren e masazhit Spa La Bella qe ndodhet ne rugen “Sulejman Delvina” dhe ne qendren e masazhit Spa Icona qe ndodhet ne rrugen “Beqir Luga”.

Ne vijim oficeret e policise gjyqesore kane hyre ne ambientet e brendshme te qendres se masazhit La Bella ku ky ambient ishte i perbere nga holli, 4 dhoma masazhi, 1 dhome ndenje, 1 ballkon. Ne pjesen e hollit u gjeten shtetasit Stelina Skuqi, Xhesika Shahu, Denada Norja, dhe Elona Cena. Ne dhomen perballe hyrjes kryesore ndodhej brenda shtetasja Albiona Toska se bashku me shtetasin Elidon Bucpapaj i cili ishte i shtrire permbys ne poltronin e masazhit, i zhveshur i mbuluar ne pjesen e vitheve. Ne dhomen ngjitur u gjet i

vetem i zhveshur, i mbuluar ne pjeset intime shtetasi Semi Rusta. Nga ana e policise gjyqesore ka vijuar kontrolli ne dhomat e masazhit ku ne dhomen ku ndodhej shtetasi Elidon Buçpapaj dhe Albiona Toska, ne sirtarin e poltronit te masazhit u gjet nje pako prezervative e pa hapur me mbishkrim “Love Sex Durex”, ne vendin e mbeturinave u gjeten tre prezervative te perdorur dhe amballazh, 1 kuti prezervativi bosh me mbishkrim “Love Sex Durex”.

Ne ballkonin e kesaj qendre ndodheshin disa thase me mbeturina te mbushura me letra te bardha te cilat pasi u hapen, brenda tyre u gjeten 3 amballazhe prezervativesh te hapura te cilat ishin bosh nga brenda. Ne tavolinen e receptionit u gjet nje fletore me ngjyre jeshile dhe nje kartemonedhe prerje 5000 leke. Ky biznes eshte i rregjistruar ne emer te shtetasit Mario Roshi i cili ka shkuar ne ambientet e biznesit gjate kohes qe po ushtrohej kontroll nga ana e oficerëve te policise gjyqesore. Prej ketyre te fundit eshte kryer kqyrja e vendit te ngjarjes me ekspert kriminalist ku sendet e gjetura u sekuestruan ne cilesine e proves materiale. Me pas eshte bere shoqerimi i personave per ne D.V.P. Tirane.

Ne te njejten kohe eshte ushtuar kontroll ne qendren e masazhit “Icona Spa” ne rrugen “Beqir Luga”, biznes i rregjistruar ne emer te shtetasit Andi Roshi, ku ne ambientet e kesaj qendre jane gjetur shtetasit Rexhina Lika, Anja Selimi (17 vjeç), Saide Buzi, Adriana Lika dhe Xhuljana Sharka. Nga ana e punonjesit te I.SH.P.SH.SH. u gjeten punonjes te pa siguruar ku u ndoqen procedura perkatese nga ana e tij. Eshte bere shoqerimi i personave per ne ambientet e D.V.P. Tirane.

Krahas veprimeve hetimore te mesiperme, qe ne momentet e para jane marre edhe deklarime nga shtetasit e meposhtem:

Eshte pyetur si person qe ka dijeni per ngjarjen shtetasia Denada Norja e cila pohon se ka filluar pune ne qendren e masazhit La Bella ne mesin e muajit Gusht te ketij viti. Ne kete qender ka takuar menaxheren Stelen e cila i ka treguar kushtet e punes, pagen etj. Me pas Denada sqaron se eshte takuar me pronarin e qendres shtetasin Mario Roshi. *Denada sqaron se gjate masazhit klientet kerkonin dhe sherbime seksuale si masturbim qe njihej si full body, kerkonin seks te mirefillte dhe seks oral. Sipas saj ishte zgjedhja e punonjeses nese do te ofronte sherbim seksual ose jo. Sipas saj nga ky aktivitet shtetasi Mario Roshi ka perfituar vetem pagesen e masazhit prej klienteve.*

Eshte pyetur si person qe ka dijeni per ngjarjen shtetasja Xhesika Shahu e cila ka sqarur se ne date 16.08.2020 ka filluar pune ne kete qender masazhi. Eshte takuar me pronarin Mario Roshi i cili i ka treguar se pervec masazhit ne varesi nga zgjedhja mund t’ju ofronte klienteve sherbime ekstra te cilat ishin masturbim, seks oral te cilat do te kishin pagese ekstra.

Ne baze te neni 37 te K.Pr.Penale deklarimet jane nderprere dhe kjo shtetase eshte njohur me letren e te drejtave. Xhesika eshte pyetur si person ndaj te cilit zhvillohen hetime per vepren penale “Prostitucioni”, parashikuar ng neni 113/1 i K.Penal. Ajo ka sqaruar menyren se si ka ofruar sherbime seksuale klienteve dhe pagesen qe ajo ka marre. Sherbimet seksuale te ofruara prej saj ndaj klienteve kane qene si masturbimi, seksi oral dhe seksi i plote. Ne lidhje me prezervativet e gjetur ne vedin e mbeturinave, Xhesika sqaron se ajo ka pare dhe here te tjera prezervativ ne koshat e mbeturinave. Ne rastet kur ajo ka kryer mardhenie seksuale me klientet e qendres, prezervativet i kane pasur klientet. *Xhensila sqaron se nga kryerja e mardhenieve seksuale dhe sherbimeve seksuale te bera me klientet e siguruar nga Mario, ajo nuk i ka bere anje pagese Marios, por ky i fundit ka perfituar vetem*

parate nga masazhi.

Eshte pyetur si person qe ka dijeni per ngjarjen shtetasja Albiona Toska e cila ka sqaruar se ne date 23.07.2020 ka filluar pune ne qendren e masazhit La Bella. Pervec masazhit Albina sqaron se ne kete qender *klientet i kerkonin* te kryente me ta mardhenie seksuale, por Albiona sqaron se ju ka ofruar klienteve vetem masazh full body qe perfshin masturbimin e klientit deri ne ejakulacion.

Ne baze te neni 37 te K.Pr.Penale deklarimet jane nderprere dhe kjo shtetase eshte njohur me letren e te drejtave. Albiona eshte pyetur si person ndaj te cilit zhvillohen hetime per vepren penale "Prostitucioni", parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal. Ajo ka sqarur ne lidhje me menyren se si e ofronte masturbimin dhe pagesen qe ajo merte per kete sherbim. Sipas saj me sigurimin e klienteve dhe kontaktet me ta e bente Mario Roshi. Ajo sqaron se ne dijenine e saj ne qendren La Bella kryhen dhe mardhenie seksuale pervec seksit oral dhe masturbimit. Ajo sqaron se menaxherja qe quhet Stelina ka dijeni qe ne qender kryhen sherbime dhe mardhenie seksuale pasi kur klientet futen ne dhomat e masazhit ka zhurma qe te bejne te besosh se aty kryhen mardhenie seksuale.

Eshte pyetur si peson qe ka dijeni shtetasja Stelina Skuqi e cila ka sqaruar se para 8 muajsh ka filluar pune tek qendra e masazhit La Bella. Sipas saj shumicen e takimeve mes punonjeseve dhe klienteve i linte Mario Roshi. Ajo sqaron se ka pasur raste *kur klientet i kane kerkuar* gjate masazhit sherbime seksuale por Stelina nuk ka pranuar te bej diçka te tille.

Ne lidhje me komunikimet e gjetura ne aparatin e saj celular me personin te identifikuar me emrin Oraldi Taxi Delux me nr.tel. 0695555311, Stelina nuk jep te dhena me interes per hetimin. Ne lidhje me prezervativet e gjetur nga ana e policise gjyqesore ne ambientet e Spa La Bella, Steliana sqaron se pervec rastit te sotem ajo ka pare dhe here te tjera prezervativ te perdorur ne koshat e plehrave dhe sirtaret e qendres. Sipas saj ajo ju ka kerkuar punonjeseve qe gjera te tilla te mos ndodhin me, pasi prania e prezervativeve tregon se eshte kryer akt seksual. Stelina eshte pyetur nga ana e oficerave te policise gjyqesore se perse nuk e ka kallezuar ne polici faktin se ne ambientet e Spa La Bella kryhen sherbime seksuale ekstra, ajo sqaron se nuk ka dashur te ngaterrohet me diçka te tille pasi shikon jeten e saj. Ne keto kushte bazuar ne nenin 37 te K.Pr.Penale deklarimet jane nderprere dhe kjo shtetase eshte njohur me letren e te drejtave. Ajo eshte pyetur si person ndaj te cilit zhvillohen hetime per vepren penale "Moskallzim i krimi", parashikuar ng neni 300 i K.Penal, ku ka sqaruar se do te jap shpjegime ne nje moment tjetër te hetimit ne prani te avokatit te zgjedhur prej saj.

Eshte pyetur si peson qe ka dijeni per ngjarjen shtetasja Elona Cena e cila ka sqarur se ka 3 dite qe ka filluar pune tek qendra e masazhit Spa La Bella. Elona sqaron *se klientet i kane kerkuar asaj* pervec masazhit te kryenin mardhenie seksuale me te dhe kur Elona i ka refuzuar ata mernin masazhatore te tjera ose vendosnin te largoheshin nga qendra. Per keto sherbime klientet kerkonin Denaden ose Xhesin.

Ne lidhje me qendren e masazhit Icona Spa, u pyet si person qe ka dijeni per ngjarjen shtetasia Adriana Lika e cila ka sqaruar se ne muajin Janar te ketij viti ka filluar pune ne qendren e masazhit Icona Spa. Adriana ka sqaruar se ne 2 – 3 raste *ajo ju ka ofruar klienteve sherbime ekstra ku klientet* jane eksituar dhe kane kaluar ne orgazem dhe per kete sherbim ka perfutuar pagese ekstra pervec pageses se masazhit. Ne baze te neni 37 te K.Pr.Penale deklarimet jane nderprere dhe kjo shtetase eshte njohur me letren e te drejtave. Adriana eshte

pyetur si person ndaj te cilit zhvillohen hetime per vepren penale “Prostitucioni”, parashikuar ng neni 113/1 i K.Penal. Ajo ka sqaruar se me sigurimin dhe kontaktin me klientet merrej Mario.

Eshte pyetur si person qe ka dijani shtetasja Xhuliana Sharka, e cila ka sqarur se ne fund te muajit Qershor te ketij viti ka filluar pune tek Icona Spa. Ajo sqaron se me pare ka punuar tek qendra e masazhit La Bella. Xhuliana sqaron *se klientet gjate masazhit kerkojne sherbime seksuale per tu ejakuluar ku ne disa raste ajo ka ofruar masturbim me dore dhe seks oral.*

Ne baze te neni 37 te K.Pr.Penale deklarimet jane nderprere dhe kjo shtetase eshte njohur me letren e te drejtave. Xhuliana eshte pyetur si person ndaj te cilit zhvillohen hetime per vepren penale “Prostitucioni”, parashikuar ng neni 113/1 i K.Penal. Ajo ka sqaruar se per masturbimin dhe seksin oral klientet e kane shperblyer me 5000 lek, pervec pageses se masazhit. Ajo sqaron se me kontaktet dhe mardheniet me klientet i mbante Mario. Ajo sqaron se dhe koleget e saj i ofrojne keto sherbime pasi kane pagese te larte.

Nga ana policise gjyqsore ne lidhje me kete rast jane pyetur si persona qe kane dijani per ngjarjen shtetasit Hamza Bezati, Semi Rusta dhe Elidon Buçpapaj, Rexhina Lika, ne prani te psikologeve Gjergji Xhaholli dhe Katerina Mullali te cilet nuk kane dhene te dhena me interes per hetimin.

Gjate hetimeve eshte bere kqyrja e aparatit celular te shtetases Stelina Skuqi si dhe jane sekuestruar ne ambientet e Spa La Bella 5000 leke te reja, nje fletore shenimesh, nje aparat DVR, nje pako prezervativ dhe nje pako prezervativ bosh.

Shtetasit Mario Roshi i jane sekuestruar 3 aparat celular, 39000 lek dhe 55 euro. Gjithashtu eshte bere kqyrja e aparatit celular te shtetasi Andi Roshi ku jane gjetur disa biseda me interes ku ne njerin prej tyre evidentohen komunikime me personin me emrin Arnest Shehu ku ky i fundit shkruan “*Ndonje gojore bejne gocat Qe te mos marr mundimin kot*” dhe bashkebiseduesi i shkruan “*Mund tvini ta provoni ja vlen Gocat jan shum tmira*”.

Andi Roshi, si person ndaj te cilit po zhvillohen hetimet i cili nder te tjera deklaroi se: Jam banor ne qytetin e Tirane me adrese te mesiperme. Aktualisht merrem me biznes privat. Dua te sqaroj se une kam pasur nje qender masazhi me emrin “Icona Spa” te cilen e kam hapur sipas rregullave ligjore me nipte dhe dokumentacion te rregullt ne vendin e quajtur “Pazari i Ri”. Ne kete qender kane qene te punesuar shtetaset Adriana Lika dhe Xhuliana te cilen nuk e mbaj mend mbiemrin dhe shtetasja Saide Buzi. *Dua te sqaroj se lidhur me punesimet e ketyre shtetaseve eshte mare vellai im shtetasi Mario Roshi, i cili ka patur dhe ky ne pronesi nje qender masazhi me emrin “La bella” prane sheshit Willson, Tirane. Per qendren e masazhit Icona Spa une vetem kam rakorduar nja dy-tre here vetem per oraret e vajzave te cilat kryenin fizioterapin (masazhe) pasi vellai im ishte i zene ne qendren tjeter dhe nuk mund ti menaxhonte dot te dyja qendrat. Qendra ka pasur dhe nje numer telefoni 069 29 60 668 i cili rinte ne reception dhe pergjigjej kush nga vajzat ishte e lire. Sqaroj se mua mund te me kete shkruar ndonje shtetas apo ndonje shok lidhur per te me kerkuar masazh dhe t’i lija orarin, por ne djenine time une vetem ju kam thene qe vajzat jane shume te pergatituara dhe bejne masazh shume te mire profesional, por nuk kam pasur asnje here qellime te tjera se nuk merresha me kete pune duke dhe mos qendruar shume te qendra. Une gjate kesaj kohe kam punuar dhe ne nje fabrike kepucesh me kohe te plote dhe nuk kam pasur shume kohe te lire te shkoja te qendra. Me te gjitha veprimet apo anen menaxheriale merrej vellai im shtetasi*

Mario Roshi, i cili siç e kam theksuar që kishte dhe qendren tjetër. Dua të them se numri im personal në atë kohë ka qenë 069 65 37 654 dhe jam i gatshëm të verifikohet në lidhje me këtë hetim, pasi nuk kam asnjë lidhje me akuzën për të cilën unë jam marrë si person në hetim.

Rezultoni se SMS-i mesazhi është dërguar në numrin e telefonit të përcaktuar dhe përdorur nga stafi i qendrës së fizioterapisë dhe jo nga telefoni i shtetasit Andi Roshi.

Në vijim të veprimeve hetimore me qëllimin e hetimit të plotë, gjithanshëm dhe objektiv të procedimit, për të përcaktuar dhe saktësuar përgjegjësinë individuale dhe kualifikimin ligjor për secilin nga të dyshuarit, janë njoftuar dhe janë marrë deklaratime në prezencë të mbrojtësit ligjor perseri shtetasve të mëposhtem:

Eshtë ripyetur shtetasja Denada Norja, *ne prani të mbrojtësit ligjor si person ndaj të cilit po zhvillohen hetimet, deklaroi se:* Jam banor në qytetin e Tiranës. Aktualisht jam pa punë. Dua të sqaroj se se jam në dijeni të këtij fakti, pasi jam pyetur në polici ku kam dhënë disa shpjegime lidhur me këtë rast, por gjendja im atë ditë ishte shumë e rënduar pasi nuk kisha shkuar ndonjë herë në polici dhe aq më tepër në lidhje me këtë situatë që po pyetesh. Dua të sqaroj se unë kam punuar pranë qendrës së masazheve “La bella” prej Gushtit/2020, mbas pjesës së karantënës. *Nepermjet Instagramit jam njohur me shtetasin Mario Roshi, i cili kishte një qendër masazhi dhe kerkonte punonjëse.* Fillimisht jam takuar me këtë shtetas të qendrës “La bella”. Kam filluar punë dhe menaxheria ishte shtetasia Stela Skuqi.

Sqaroj se qendra kishte një numër telefoni të cilën nuk e mbaj mend, por telefoni ishte Samsung. Nepermjet telefonit lihej rezervimi dhe pagesa ishte 4000 mijë lekë të vjetra për 60’. Në lidhje me veprimet e tjera që janë pretenduar se kryeshin nga ana ime në këtë qendër masazheve nuk është e vertet, nuk e di si janë shkruajtur atë ditë nga punësit e policisë. Unë personalisht kryej vetëm masazh trupit dhe asnjë gjë tjetër. Dua të sqaroj një fakt se për sa është *vertet kur benim masazh, kliente të ndryshëm kerkonin shërbime ekstra*, por nga ana ime janë refuzuar dhe vetëm masazh bëja. Kur klientet ngeleshin të kenaqur nga masazhi që unë ofroja, më linin dhe bakshish më deshën e tyre në vlerën 1000 mijë lekë të vjetra ose 2000 mijë lekë të vjetra. Lidhur me pretendimin e disa prezervativë që janë gjetur në qendër nuk di se të kujt mund të jenë. Siç e kam shpjeguar dhe më lartë nuk kemi bërë shërbime ekstra me pagesë dhe nga menaxheria dhe nga pronari na është thënë gjithmonë lidhur me këtë gjë që mos të beheshin në qendër tonë, pavarësisht që ne e kishim apo unë personalisht nuk i bëja gjëra të tilla.

Shtetasja Stelina Skuqi, *pyetur në prani të mbrojtësit ligjor si person ndaj të cilit po zhvillohen hetimet deklaroi se:* Jam banor në qytetin e Tiranës, aktualisht jam studente. Dua të sqaroj se se jam në dijeni të këtij fakti, pasi jam pyetur në polici ku kam dhënë disa shpjegime lidhur me këtë rast, por gjendja im atë ditë ishte shumë e rënduar pasi nuk isha shkuar ndonjë herë në polici dhe aq më tepër në lidhje me këtë situatë që po pyetesh. Dua të sqaroj se unë kam punuar pranë qendrës së masazheve “La bella” prej 8 muajsh, duke përjashtuar pjesën e karantënës. Unë studioj për Shkenca politike pranë Universitetit të Tiranës. *Nepermjet një shoqësie time kam kerkuar për t’u përsosur pranë qendrës së masazheve me pronar shtetasin Mario Roshi, i cili kishte një qendër të masazheve dhe kerkonte punonjëse.* Kam filluar punë si menaxhere dhe rakordoja më oraret e personave që vinin në qendër. Tek qendra që unë punoja si menaxhere vella i shtetasit Mario Roshi, Andi Roshi nuk ka ardhur ndonjëherë dhe unë nuk e kam takuar, tani më vonë kam marrë vesh që ai kishte një vella se

nuk me ka rene muhabeti dhe une menaxhoja vetem anen monetare ne qender. Lidhur per faktin e disa prezervativeve qe jane gjetur ne qender, nuk mund ta percaktoj dot sakte se per cfare jane ndodhur aty, pasi kur vajzat shkonje per te bere masazh jane vetem ne dhome dhe nuk futet njeri. Por ne qendren tone nuk ka pasur pagesa ekstra pasi si une dhe Mario i kishim porositur vajzat qe nese klientet kerkonin sherbime ekstra nuk duhej te pranonin pasi nuk ishte gje e ligjshme. Siç e kam theksuar qe kur kam pare prezervativet ne sirtare nuk kam vene njeri ne djeni, pasi nuk kam pare diçka konkrete me syte e mi qe te vija gishtin te ndonje person. Por dua te them si une dhe Mario i kemi porositur vajzat qe nese klientet kerkonin sherbime ekstra te mos pranonin.

Shtetasja Xhesika Shahu, pyetur ne prani te mbrojtetit ligjor si personi ndaj te cilit po zhvillohen hetimet deklaroi se: Jam banor ne qytetin e Tirane, aktualisht jam pa pune. Dua te sqaroj se se jam ne djeni te ketij fakti, pasi jam pyetur ne polici ku kam dhene disa shpjegime lidhur me kete raste, por gjendja im ate dite ishte shume e renduar pasi nuk isha shkuar ndonje here ne polici dhe aq me teper ne lidhje me keto shtetas qe po pyetesh. Dua te sqaroj se une kam punuar prane qendres se masazheve "La bella" prej Gushtit/2020, mbas pjesen e karantines. Nepermjete nje shoqes time jam njohur me shtetasin Mario Roshi, i cili kishte nje qender masazheve dhe kerkonte punonjese. Fillimisht jam takuar me kete shtetas te qendra "La bella". Kam filluar pune dhe menaxheria ishte shtetasja Stela Skuqi. Sqaroj se qendra kishte nje numer telefoni te cilin nuk e mbaj mend, por telefoni ishte Samsung. Nepermjet telefonit lihej rezervimi dhe pagesa ishte 4000 mije leke te vjetra 60`. Ne lidhje me veprimet e tjera qe jane pretenduar se kryeshin nga ana ime ne kete qender nuk eshte e vertet, nuk e di si jan shkruajtur ate dite nga punonjesit e policise. Une personalisht kryej vetem masazh trupi dhe asnje gje tjeter. Dua te sqaroj nje fakt se per sa eshte vertet kur benim masazh, kliente te ndryshem kerkonin sherbime ekstra, por nga ana ime jane refuzuar dhe vetem masazhe beja. Kur klientet ngeleshin te kenaqur nga masazhi qe une ofroja, me linin dhe bakshish me deshiren e tyre ne vleren 1000 mij leke te vjetra ose 2000 mije leke te vjetra. Lidhur me pretendimin e disa prezervativeve qe jane gjetur ne qender nuk di sete kujt mund te jene. Siç e kam shpjeguar dhe me lart nuk kemi bere sherbime ekstra me pagese dhe nga menaxheria dhe nga pronari na eshte thene gjithmone lidhur me keto gjera qe mos te beheshin ne qendren tone, pavarishte qe une personalisht nuk i beja gjera te tilla.

Shtetasja Xhuljana Sharka, pyetur ne prani te mbrojtetit ligjor si personit ndaj te cilit po zhvillohen hetimet deklaroi se : Jam banor ne qytetin e Tirane, aktualisht jam estetiste. Dua te sqaroj se se jam ne djeni te ketij fakti, pasi jam pyetur ne polici ku kam dhene disa shpjegime lidhur me kete rast, por gjendja im ate dite ishte shume e renduar pasi nuk kisha shkuar ndonje here ne polici dhe aq me teper ne lidhje me keto shtetas qe po pyetesh. Dua te sqaroj se une kam punuar prane qendres se masazheve "Icon Spa" prej Qershorit/2020, duke perjashtuar pjesen e karantines. Kam qene ne shkolle per masazhe dhe per kete gje kam kerkuar pune te ushtrija profesionin. Nepermjet instragramit jam njohur me shtetasin Mario Roshi, i cili kishte nje qender masazheve dhe kerkonte punonjese. Fillimisht jam takuar me kete shtetas te qendra "La bela" dhe me ka thene se kishte dhe nje qender te dyte, ne rrugen Beqir Luga dhe aty kerkonte punonjese. Kam filluar pune dhe menaxheri ishte shtetasi Mario Roshi. Aty vinte dhe i vellai i tij shtetasi Andi Roshi, i cili rinte dhe pinte ndonje kafe, por maredhenin e lekeve te punes se masazheve ne i benim me shtetasin Mario Roshi. Shtetasin Andi Roshi e njihnim se ishte i vellai i pronarit. _

Sqaroj se qendra kishte nje numer telefoni te cilin nuk e mbaj mend, por telefoni ishte Samsung. Nepermjet telefonit lihej rezervimi dhe pagesa ishte 4000 mije leke te vjetra 60`. Kliente sillte dhe shtetasi Mario Roshi. Shtetasi Andi Roshi nuk sillte kliente. Ne lidhje me veprimet e tjera qe jane pretenduar se kryeshin nga ana ime ne kete qender te masazheve nuk eshte e vertete, nuk e di si jane shkruajtur ate dite nga punonjesit e policise. Une personalisht kryej vetem masazh trupi dhe asnje gje tjeter. Dua te sqaroj nje fakt se per sa eshte vertet kur benim masazh, kliente te ndryshem kerkonin sherbime ekstra, por nga ana ime jane refuzuar dhe vetem masazhe beja. Kur klientet ngeleshin te kenaqur nga masazhi qe une ofroja, me linin dhe bakshish me deshiren e tyre ne vleren 1000 mij leke te vjetra ose 2000 mije leke te vjetra.

Ne analizen ligjore te fakteve dhe provave te mbledhura gjate hetimeve paraprake organi i akuzes ka konkluduar se te dyshuari Mario Roshi dhe Andi Roshi jane pikerisht personat qe kane hapur dy qendrat e SPA per te ushtruar aktivitet te ligjshem te fizioterapise. Nderkohe qe me veprimet konkrete, si gjetjen dhe punesimin e stafit, sigurimin e ambienteve eshte marre kryesisht shtetasi Mario Roshi, i cili ka komunikuar, ka siguruar e ka punesuar disa shtetase per te kryer fizioterapi ne keto qendra per persona te ndryshem kunderejt pageses pekatese.

Nga te gjitha veprimet proceduriale te kryera nga policia gjyqesore ne kushtet e flagrances, kontrolli i ambienteve, marrja e deklarimeve nga persona qe kane dijeni apo ndaj te cileve zhvillohen hetimet, sekuestrimi i provave materiale, keqyra e sendeve dhe vendeve etj, ne asnje rast, ne asnje moment ne dy qendrat ku behej fizioterapi nuk ka rezultuar te jete kryer ndonje veprim i kunderligjshem, si ushtrim prostitucioni apo veprime te tjera.

Gjithashtu ka rezultuar e provuar se ne keto qendra shtetasi Mario Roshi kishte te punesuar dhe menaxhere shtetasen Stelina Skuqi, njekohesisht ai kishte siguruar dhe nje telefon celular per te komunikuar dhe prenotuar orarin per shtetas te ndryshem me keto qendra kur ata e gjykonin te nevojshme per te marre sherbimin e fizioterapise. Krahas komunikimit te mesiperme jane perdorur edhe rrjetet sociale per te dhene njoftimet perkatese si per personat qe kerkonin te punesoheshin ne keto qendra dhe per persona apo shtetas te ndryshem qe kerkonin sherbimet e fizioterapise. Ne ndonje rast edhe shtetasi Mario Roshi ka komunikuar me punonjeset e qendres per te fiksuar orare per persona te njohur per te marre sherbimin e fizioterapise, pa kerkuar asgje me shume. Konstatohet lehtesisht se te gjitha keto te dhena dhe menyra komunikimi kane qene publike dhe te aksesueshem per kedo qe deshironte dhe kerkonte te frekuentonte keto qendra per te marre nje sherbim te ligjshem.

Te gjitha keto rrethana te mesiperme jane pohuar ne deklarime nga te gjitha personat e punesuar prane ketyre dy qendrave, si dhe jane pohuar edhe nga vete shtetasit Andi dhe Mario Roshi.

Sic rezulton nga momenti i i fillimit te aktivitetit te ketyre dy qendrave shtetasi Andi Roshi nuk ka shtyre, ndermjetesuar, marre shperblim apo bashkepunuar as me shtetasin Mario Roshi dhe as me asnje nga shtetaset e punesuara ne keto qendra. Keto rrethana e fakte tashme jane te provuara tej cdo dyshimi. Eshte plotesisht e vertete se nga shtetas te ndryshem qe frekuentonin keto qendra here pas here u eshte kerkuar punonjesve te ketyre qendrave edhe sherbime eksta, por sic konkludohet keto kerkesa jo vetem jane bere ne menyre individuale nga ata por dhe zgjidhja e ketij sherbimi eshte bere po ne menyre individuale nga

shtetaset e punesuara prane qendrave, (referuar akteve procedurale sipercituar).

Nga permbajtja e deklarimeve te shtetaseve te punesuara rezulton se shtetasin Andi Roshi thjesht e njohin si vellai i Marios, pasi Mario dhe Andi nuk kane perfituar asnje te ardhur nga sherbimet ekstra qe mund apo dyshohet ta kene ofruar punonjeset per klientet. Edhe ne deklarimet e vete shtetasve Andi dhe Mario Roshi rezulton i provuar i njeji mekanizem, sic eshte pohuar ne teresia nga vajzat e punesuara.

Si konkluzion rezulton e provuar teresisht se shtetasi Andi Roshi nuk ka punesuar, nuk ka ndermjetesuar, shtyre apo perfituar e pasur ne asnje rast dijeni per ndonje aktivitet te paligjshem qe dyshohet se eshte kryer ne keto qendra. Ai thjesht ka ndihmuar ne ndonje rast vellain e tij shtetasin Mario Roshi ne mirevajtjen e puneve ne keto aktivitete.

Vetem fakti se shtetasi Andi Roshi eshte vellai i shtetasit Mario Roshi pa pasur ne asnje moment asnje lidhje, ndikim, te kete punesuar, perfituar apo kerkuar e nderhyre ne aktivitetin e tij nuk passjell rezultatin se ka konsumuar elementet e vepres penale te parashikuar nga neni 114/2, 115 i K.Penal, apo te ndonje vepre penale tjeter. Edhe momenti i nje sms te derguar ne telefon, sic rezulton nga deklarimet sipercituara telefoni ka qene i destinuar e perdorur vetem per komunikime ne qendren perkatese te SPA se shtetasit Andi Roshi, per rrjedhoje nuk eshte komunikimi i shtetasit Andi Roshi, i cilli ka pasur te regjistruar e ne perdorim numer telefonik tjeter.

Nderkohe qe shtetasi Mario Roshi thjesht ka qene personi qe ka punesuar shtetaset ne keto qendra, por ne asnje nuk ka ndermjetesuar, shtyre apo perfituar e pasur ne asnje rast dijeni per ndonje aktivitet te paligjshem qe dyshohet se eshte kryer ne keto qendra. Shtetasi Mario Roshi eshte personi pergjegjes per funksionimin e dy qendrave te mesiperme duhet te kishte kontrolluar ne vijimesi cdo aktivitet qe kryhej brenda ketyre qendrave dhe te parandalonte ndonje episod sporadik qe dyshohet se ka ndodhur ne keto qendra.

Nje moment mjaft i rendesishem per ecurine e procesit eshte dhe procedura e funksionimit te ketyre qendrave te fizioterapise. Sic rezulton e provuar keto qendra ofrojne kryerjen e fizioterapise ne dhoma te vecanta, te ndara me vete dhe vetem ne pranine e punonjeses qe kryen sherbimin perkates dhe personit i cili ka kerkuar kete sherbim. Eshte zgjedhje teresisht individuale raporti qe mund te krijohet ndermjet ketyre dy personave dhe ne asnje moment nga Andi dhe Mario Roshi nuk eshte kerkuar apo ndikuar ne keto raporte individuale mes paleve.

Gjithashtu eshte per t'u theksuar se per aktivitetin qe zhvillohet brenda qendres se fizioterapise nuk ka asnje mundesi objektive te vije ne dijeni asnje nga punonjeset e qendres, per shkak te ruajtjes se privatesise se sherbimit.

Edhe nga procesverbalet e kontrollit ne flagrance te ketyre qendrave eshte konfirmuar plotesisht ky fakt i rendesishem pasi nuk rezulton te jete gjendur apo kapur ndonje person konkret ne kryerje e siper te ndonje aktiviteti te paligjshem sic eshte rasti konkret, ushtrimit te prostitucionit.

Ne baze te nenit 1 te Kodit te Procedures Penale, legjislacioni procedural penal ka per detyre te siguroje nje procedim te drejte, te barabarte e te rregullt ligjor, te mbroje lirite personale dhe te drejtat e interesat e ligjshme te shtetasve, ne baze te nenit 2 te Kodit te Procedures Penale parashikohet se respektimi i normave procedurale eshte i detyrueshem per subjektet e procedimit penal, per organet shteterore, personat juridike dhe shtetasit.

Per marrjen e nje personi ne pergjegjesi penale eshte e nevojshme qe ne veprimet ose

mosveprimet e tij te ekzistojne elementet e nje figure te caktuar te vepres penale, te parashikuar nga ligji penal. Respektimi dhe plotesimi i elementeve te figures se vepres penale ka rendesi te vecante, sepse ka te beje me zbatimin e parimit te ligjshmerise nepermjet te cilit, shoqeria si entitet, kontrollon anetaret e saj permes kontrollit ligjor te anetareve te shoqerise. Per te pasur nje figure konkrete te vepres penale eshte e domosdoshme ekzistenca e te gjithë elementeve perberes te saj, te marra se bashku, te cilet jane: a) objekti i vepres penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive. Provueshmeria e elementeve objektive dhe subjektive te figures se vepres penale, sherben si baze per te vene nje person perpara pergjegjesise penale.

Nese nuk ekziston apo nuk provohet qofte edhe njeri prej ketyre elementeve ligjore, personi nuk mund te merret nen pergjegjesi penale dhe rrjedhimisht as edhe te denohet.

Edhe Gjykata e Larte ne jurisprudencen e saj konstante thekson se provat penale dhe procesit i te provuarit, lidhet ne menyre te drejtperdrejte me permbajtjen dhe detyren e procedures penale, e cila ka per qellim dhe zhvillimin e nje gjykimi te drejte e te rregullt, sa i perket procesit te zbulimit dhe te provuarit te se vertetes nepermjet mjeteve dhe menyrave te parashikuara ne ligj. Rendesia e shqyrtimit dhe e verifikimit te provave gjate gjykimit te çeshtjes eshte percaktuese per formimin e bindjes se brendshme te gjykates, mbi bazen e se ciles do te percaktohet vertetesia dhe fuqia e tyre provuese. (Shih Vendimin nr. 291, date 15.03.2007, te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte).

Edhe me pare ky Kolegj (shih Vendimin nr. 25, date 15.01.2003 i Kolegjit Penal i Gjykates se Larte) ka theksuar se: *“Percaktimi i vertetesise se proves qe eshte vene si kusht nga ligjvenesit per te patur nje proces ligjor çmuarje te saj, nenkupton...verifikimi se ku konsiston lidhja e rrethanes apo objektit material konkret me objektin e te provuarit ne çdo gjykim konkret, te cilin e perbejne pergjigjet qe duhet t’u jape gjykata pyetjeve te tilla si: çfare ka ndodhur, ku dhe kur ka ndodhur, me ç’mjet eshte kryer, si ka ndodhur, kush dhe pse e ka kryer vepren, pergjigje, te cilat duhet te perbejne shtratin mbi te cilin duhet ndertuar pjesa arsyetuese e çdo vendimi gjyqesor ne procesin penal”*. Po keshtu eshte shprehur se: *“Procesi i te provuarit (...) eshte vertetimi i fakteve nepermjet grumbullimit te provave te mjaftueshme per te bindur gjykatën lidhur me fajesine e tij (te pandehurit) (...)”*. (Vendimi nr. 205, date 06.04.2005 i Kolegjit Penal te Gjykates se Larte).

Barren e proves per te provuar faktet objekt akuze i ka organi i prokurorise, i cili nepermjet provave te paraqitura ne gjykim, duhet t’i krijojë gjykates bindjen “pertej çdo dyshimi te arsyeshem”, se vepra penale eshte kryer dhe se ajo eshte kryer nga i pandehuri. Gjykata e themelit, per te percaktuar faktin kriminal, ka detyrimin te respektojë parimin e prezumimit te pafajesise parashikuar nga neni 4 te K.Pr.Penale, sipas te cilit: çdo dyshim per akuzën çmohet ne favor te te pandehurit. Edhe Gjykata Kushtetuese ne vendimin nr. 57, date 21.12.2012, ka verejtur se: prezumimi i pafajesise perbehet nga disa aspekte, njeri prej te cilit eshte *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon ne favor te te pandehurit.

Kryerja e vepres penale nga pikepamja e dinamikes kohore, zhvillohet sipas nje rrjedhe kriminale komplekse, qe artikulohet ne faza te ndryshme, duke filluar nga faza e konceptimit. Faze kjo, gjate se ciles tek subjektet aktive te vepres penale, lind dhe zhvillohet mendimi per te kryer vepren penale. Kjo faze paraqitet vetem ne rastin e kryerjes se veprave penale me dashje, pasi vetem keto lloj veprash penale jane te karakterizuara nga “qellimi” per te ndermarre veprimin kriminal te kunderligjshem. Per te vijuar me pas, me fazen e venies ne

jete te mendimit kriminal, duke realizuar keshtu veprimin kriminal te kunderligjshem dhe eventualisht pasojen e parashikuar nga dispozita penale inkriminuese. Me tej, faza ekzekutuese permbyllet me fazen e konsumimit te plote te vepres penale, te filluar nga ana e subjektit aktiv te vepres penale. Duke iu kthyer llojit te vepres penale dhe rrethanave te kryerjes se saj, vleresohet se ajo kerkon nje bashkeveprim te harmonizuar midis bashkepunetoreve. Ne rastin konkret nuk rezulton te kemi as dijeni apo marredhenie bashkepunimi, apo te tjeter lloji midis te dyshuarve Andi Roshi dhe Marioi Rosjhi., ndaj çmojme se ky aspekt eshte tejet i rendesishem per percaktimin e pergjegjesise se sejcilit.

Ne lidhje me konfigurimin e vepres penale te bashkepunimit (eventual) te personave ne nje veper penale, jane te nevojshem: 1) pluraliteti i subjekteve aktive, 2) realizimi i nje vepre penale te parashikuar si te atille nga ligji material penal, 3) kontributi objektivisht relevant i bashkepunetorit (perkatesisht i ndare sipas roleve vertikale: organizatore, ekzekutore, shtytes, ndihmes, apo te ndare horizontalisht sipas puneve ne vepren e perbashket (Vendimi Unifikues nr. 1, date 12.03.2002), dhe 4) elementi subjektiv. Ne percaktimin e kushteve te marreveshjes per kryerjen e vepres penale ne bashkepunim, ana subjektive ne kryerjen e vepres penale ne bashkepunim konsiston ne dy elemente: - ndergjegjja dhe vullneti i personit per te kryer vepren penale dhe - vullneti per te bashkepunuar me persona te tjere per kryerjen e saj. (Vendimi Unifikues nr. 4, date 15.04.2011).

Barren e proves per te provuar akuzen e ka organi i akuzes, i cili duhet nepermjet provave te paraqitura ne gjykim, t'i krijojte gjykates bindjen “pertej çdo dyshimi te arsyeshem” se vepra penale eshte kryer dhe se ajo eshte kryer nga i pandehuri.

Edhe ne zbatimin e nenit 152/2 te Kodit te Procedures Penale, duhet te vleresojme secilin element indicjar provues, duke shqyrtuar aftesine e tyre provuese ne drejtim te tregimit te pergjegjesise se te pandehurit, duke shpjeguar ne menyre te detajuar kriterin dhe logjiken e ndjekur nepermjet nje arsytimi korrekt juridik, qe eventualisht mund te kontrollohet nga gjykatat me te larta.

Ne te tilla rrethana, ne mungese te prova te tjera lidhja e elementeve te anes materiale me autorin e vepres penale, ne menyre qe te provohet kryerja e anes objektive e faktit penal dhe, sidomos bashkepunimi, nuk mund te thuhet se eshte e provuar dhe e arsytuar ne perputhje te plote me nenin 4 te Kodit te Procedures Penale. Nje moment mjaft i rendesishem procedural jane edhe parashikimet ligjore te neneve 156 dhe 167 te K.Pr.Penale, permbajtja e te cileve vjen ne unison te plote me parashikimet e sipercituara dhe perben nje argumnet me shume qe shtetasi Andi Roshi nuk ka konsumuar elementet e ndonje vepre penale.

Per sa me siper nga prokurorja u kerkua deklarimi fajtor i te pandehurit Mario Roshi, per vepren penale te “Mbajtja e lokaleve per prostitucion”, te parashikuar nga neni 115 i K.Penal; deklarimin fajtor te te pandehurave Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika, Xhuliana Sharka, per vepren penale te “Prostitucionit”, te parashikuar nga neni 300 i K.Penal; pushimin e hetimeve te procedimit penal nr. 5718, viti 2020 per vepren penale te “Mbajtjes te lokaleve pe prostitucionit” te parashikuar nga neni 114 i K.Penal ne ngarkim te shtetasit Andi Roshi; pushimin e hetimeve te procedimit penal nr. 5718, viti 2020 per vepren penale te “Shfrytezimit te prostitucionit” te parashikuar nga neni 115 i K.Penal ne ngarkim te shtetasit Mario Roshi.

Nisur nga sa me siper Gjykata cmon se kerkesa e organit te prokurorise per pushimin

e çeshtjes penale ne ngarkim te shtetasit Andi Roshi per vepren penale te “Mbajtjes te lokaleve pe prostitucionit” te parashikuar nga neni 115 i K.Penal dhe pushimin e çeshtjes penale ne ngarkim te shtetasit Mario Roshi per vepren penale te “Shfrytezim te prostitucionit” te parashikuar nga neni 114 i K.Penal, eshte e drejte pasi ne zbatim te parashikimeve te nenit 329/a te K.Pr.Penale, procedimi i rregjistruar per nje krim pushohet me kerkese te prokurorise kur konstatohen rastet e parashikuara nga neni 328 pg.1 i Kodit Penal. Ne nenet e mesiperme eshte parashikuar shprehimisht se :

Neni 329/a pg.1 parashikon se: *“1. Ne perfundim te hetimeve paraprake, kur procedohet per krime dhe kur eshte njeri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, te ketij Kodi, prokurori i kerkon gjyqtarit te seances paraprake pushimin e akuzes ose çeshtjes.”*

Neni 328 pg.1 parashikon se : *“1. Ne perfundim te hetimeve paraprake, kur procedohet per kundervajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzes ose çeshtjes kur:*

- a) del qarte se fakti nuk ekziston;*
- b) fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale;*
- c) viktimi nuk ka bere ankim ose heq dore nga ankimi ne rastet qe procedimi fillon me kerkesen e tij;*
- ç) personi nuk mund te merret si i pandehur ose nuk mund te denohet;*
- d) ekziston nje shkak qe e shuan vepren penale ose per te cilin ndjekja penale nuk duhej te fillohej ose nuk duhet te vazhdoje;*
- dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer vepren ose nuk provohet qe e ka kryer ai;*
- e) me vendim te formes se prere i pandehuri eshte gjykuar per te njejten veper penale;*
- e) i pandehuri vdes;*
- f) ne rastet e tjera te parashikuara me ligj.”*

Neni 134/1 i K.Penal parashikon se : *Vjedhja e pasurise denohet me gjobe ose burgim gjer ne tre vjet... ”.*

Gjykata çmon se ne rastin konkret prokurorja me te drejte ka arritur ne konkluzionin se personi nen hetim Mario Roshi nuk ka kryer vepren penale te parashikuar nga neni 115 i K.Penal, gjithashtu nuk rezulton qe i pandehuri Mario Roshi te kete kryer vepren penale te parashikuar nga neni 114 i K.Penale, pasi nga permbajtja e deklarimeve te shtetaseve te punesuara rezulton se shtetasin Andi Roshi thjesht e njohin si vellai i Marios, pasi Mario dhe Andi nuk kane perfituar asnje te ardhur nga sherbimet ekstra qe mund apo dyshohet ta kene ofruar punonjeset per klientet. Edhe ne deklarimet e vete shtetasve Andi dhe Mario Roshi rezulton i provuar i njejti mekanizem, sic eshte pohuar ne teresia nga vajzat e punesuara.

Nga hetimet rezulton e provuar teresisht se shtetasi Andi Roshi nuk ka punesuar, nuk ka ndermjetesuar, shtyre apo perfituar e pasur ne asnje rast dijani per ndonje aktivitet te paligjshem qe dyshohet se eshte kryer ne keto qendra. Ai thjesht ka ndihmuar ne ndonje rast vellain e tij shtetasin Mario Roshi ne mirevajtjen e puneve ne keto aktivitete.

Vetem fakti se shtetasi Andi Roshi eshte vellai i shtetasit Mario Roshi pa pasur ne asnje moment asnje lidhje, ndikim, te kete punesuar, perfituar apo kerkuar e nderhyre ne aktivitetin e tij nuk passjell rezultatin se ka konsumuar elementet e vepres penale te parashikuar nga neni 114/2, 115 i K.Penal, apo te ndonje vepre penale tjeter. Edhe momenti i nje sms te derguar ne telefon, sic rezulton nga deklarimet sipercituara telefoni ka qene i destinuar e perdorur vetem per komunikime ne qendren perkatese te SPA se shtetasit Andi Roshi, per

rrjedhoje nuk eshte komunikimi i shtetasit Andi Roshi, i cili ka pasur te regjistruar e ne perdorim numer telefonik tjeter. Nderkohe qe shtetasi Mario Roshi thjesht ka qene personi qe ka punesuar shtetaset ne keto qendra, por ne asnje nuk ka ndermjetesuar, shtyre apo perfituar e pasur ne asnje rast dijeni per ndonje aktivitet te paligjshem qe dyshohet se eshte kryer ne keto qendra. Shtetasi Mario Roshi eshte personi pergjegjes per funksionimin e dy qendrave te mesiperme duhet te kishte kontrolluar ne vijimesi cdo aktivitet qe kryhej brenda ketyre qendrave dhe te parandalonte ndonje episod sporadik qe dyshohet se ka ndodhur ne keto qendra.

Sic rezulton e provuar keto qendra ofrojne kryerjen e fizioterapise ne dhoma te vecanta, te ndara me vete dhe vetem ne pranine e punonjeses qe kryen sherbimin perkates dhe personit i cili ka kerkuar kete sherbim. Eshte zgjedhje teresisht individuale raporti qe mund te krijohet ndermjet ketyre dy personave dhe ne asnje moment nga Andi dhe Mario Roshi nuk eshte kerkuar apo ndikuar ne keto raporte individuale mes paleve. Edhe nga procesverbalet e kontrollit ne flagrance te ketyre qendrave eshte konfirmuar plotesisht ky fakt i rëndesishem pasi nuk rezulton te jete gjendur apo kapur ndonje person konkret ne kryerje e siper te ndonje aktiviteti te paligjshem sic eshte rasti konkret, ushtrimit te prostitucionit.

Ne rastin konkret Gjykata cmon se nga ana e prokurores jane kryer veprimet e duhura hetimore dhe ajo ka arritur ne perfundimin se duhet vendosur pushimi i ceshtjes penale ne ngarkim te shtetasit Andi Roshi per vepren penale te parashikuar nga neni 115 dhe ne ngarkim te shtetasit Mario Roshi per vepren penale te parashikuar nga neni 114 i K.Penal. Gjykata nuk konstaton ndonje veprim qe nuk eshte kryer nga ana e prokurores, qe nese do kryhej mund te bente prokuroren te arrinte ne nje konkluzion te ndryshem nga ai qe ka arritur.

Gjykata çmon se rezulton teresisht e provuar se i pandehuri Mario Roshi ka konsumuar elementet e vepres penale te “Mbajtja e lokaleve per prostitucion”, te parashikuar nga neni 115 i Kodit Penal dhe ai duhet te deklarohet fajtor per sa akuzohet.

Neni 115 i Kodit Penal parashikon se: “Mbajtja, shfrytezimi, financimi, dhenia me qira e lokaleve per ushtrim te prostitucionit, denohet me gjobe ose me burgim gjer ne dhjete vjet.”.

Objekti i vepres penale te “Mbajtja e lokaleve per prostitucion” jane marrdheniet juridike te vendosura me ligj ligj per te garantuar mbrojtjen e moralit shoqeror, dinjitetit, te drejtave dhe lirive te njeriut, te mbrojtur posaçerisht nga ligji penal nga veprimet apo mosveprimet e kundraligjshme e shoqerisht te rrezikshme. Ne rastin konkret, i pandehuri Mario Roshi, me ane te veprimeve te kundraligjshme e shoqerisht te rrezikshme e ka cenuar kete objekt, pasi me veprimet e tij te drejtperdrejta dhe te vullnetshme ka konsumuar vepren penale te mbajtjes se lokaleve per prostitucionit, parashikuar nga neni 115 i Kodit Penal. Me veprimet e tij ka cenuar marrdheniet juridike te vendosura nga ligji per te garantuar moralit shoqeror, dinjitetit, te drejtave dhe lirive te njeriut, te mbrojtur posaçerisht nga ligji penal nga veprimet apo mosveprimet e kundraligjshme e shoqerist te rrezikshme.

Nga ana objektive, vepra penale e “Mbajtja e lokaleve per prostitucion” kryhet nepermjet veprimeve apo mosveprimeve te kundraligjshme e shoqerisht te rrezikshme. Me lokal duhet kuptuar çdo hapësire te mbyllur e cila eshte e pershtatshme per ushtrimin e veprimtarise se prostitucionit. Vepra penale e “Mbajtja e lokaleve per prostitucion”

sanksionon ndihmen e dhene per veprimtarine e prostitucionit neper mes te ofrimit te lokalit (hapesires) per ushtrimin e prostitucionit ne cilendo forme te se drejtes per pronesine dhe te drejtave tjera reale (si pronar, qiradhenes, qiramarres, shfrytezues apo si person pergjegjes per administrimin e tij).

Kjo veper penale kryhet ne disa menyra dhe konkretisht me mbajtjen e lokaleve per ushtrimin e prostitucionit, qe nenkupton lirimimin e baneses apo dhomes per ushtrimin e prostitucionit, te cilat sherbejne kryesisht per ushtrimin e prostitucionit; Me shfrytezimin e lokaleve per ushtrimin e prostitucionit, qe nenkupton shfrytezimin e banesave apo dhomave here pas here per ushtrimin e prostitucionit, por qe nuk sherbejne ne menyre te perhershme per ushtrimin e prostitucionit; Me financimin e lokaleve per ushtrimin e prostitucionit, qe nenkupton dhenien e parave, malrave apo sherbimeve per ndertimin e lokaleve me qellim shfrytezimin apo perdorimin e tyre per ushtrimin e prostitucionit; Me dhenien me qera te lokaleve per ushtrimin e prostitucionit, qe nenkupton kalimin e posedimit te baneses ose dhomes, kundrejt nje shperblimi, tek persona te trete, per ushtrimin e prostitucionit.

Subjekti i kesaj vepre penale eshte i pandehuri Mario Roshi, qe ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe eshte i pergjegjshem para ligjit.

Ana subjektive e figures se vepres penale lidhet me qendrimin psikik qe mban personi kundrejt vepres se kryer prej tij. Gjykata vlereson se i pandehuri Mario Roshi ka vepruar me dashje direkte duke parashikuar se veprimet e tij perbejne veper penale dhe ka deshiruar ardhjen e pasojave te tyre. I pandehuri ne cilesine e administratorit te qendrave te masazhit i ka shfrytezuar keto ambiente per te mundesuar ushtrimin e prostitucionit nga te pandehurat Denada Norja, Xhesika Shahu, Albiona Toska, Adriana Lika dhe Xhuliana Sharka.

Gjithashtu per sa me siper Gjykata, cmon se, me provat e administruara ne seance gjyqesore dhe te analizuara me siper, provohet plotesisht se nga te pandehurat Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika dhe Xhuliana Sharka jane konsumuar plotesisht, elementet e vepres penale te "Prostitucionit", parashikuar nga neni 113/1 i K.Penal.

Gjykata veren se, neni 113 i K.Penal parashikon se : *"Ushtrimi i prostitucionit denohet me gjobe ose me burgim gjer ne tre vjet.*

Dhenia e shperblimit per perfitim personal te prostitucionit denohet me gjobe ose me burgim gjer ne tre vjet."

Nga interpretimi i kesaj dispozite rezulton se, ligjvenesit ka parashikuar nje mbrojtje te posaçme, per nje marredhenie juridike te rendesishme, siç eshte ajo e vendosur nga shteti per te garantuar normat e moralit te shoqerise sone, te cilat jane ne kundërshtim te plote me dukurine negative te prostitucionit. Sipas nenit 113 te K.Penal, qe te ekzistojte vepra penale e parashikuar nga ky nen duhet qe :

- te ekzistojte objekti i vepres penale, d.m.th. te vertetohet ushtrimi i prostitucionit.
- nga ana objektive, autori i vepres penale me veprime aktive, te kundraligjshme te ushtroje prostitucionin si burim per sigurimin e jeteses. Ne kete kontekst rezulton se, element thelbesor i prostitucionit eshte marrja e shperblimit per ushtrimin e tij, ose dhenien e shperblimit per perfitim te prostitucionit.
- subjekti i vepres penale te kete mbushur moshen per pergjegjesi penale, pra te jete mbi 14 vjeç dhe i afte menderisht;

- autori i veprës të veprës me dashje, me qëllim përfitimi personal.

Ne rastin konkret, siç rezultoi edhe nga shqyrtimi gjyqësor, të pandehurat Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika dhe Xhuliana Sharka kanë ofruar shërbime seksuale klienteve të ndryshëm kundrejt pagesës. Gjithashtu rezultoi se të pandehurat janë të përgjegjshme, kanë qenë mbi 14 vjeç në kohën e kryerjes së këtij krimi. Në këtë mënyrë, e kanë plotësuar moshën për përgjegjësi penale të parashikuar nga neni 113 i K.Penal.

Gjithashtu gjatë këtij gjykimi rezultoi e provuar se e pandehura Stelina Kuqi ka konsumuar plotësisht veprën penale të “Moskallezimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, prandaj Gjykata çmon se ai duhet deklaruar fajtor për sa akuzohet.

Neni 300 i K.Penal parashikon se: *“Moskallzimi në organet e ndjekjes penale, në gjykatë, në organet e rendit publik, të pushtetit ose të administratës, i një krimi që është duke u kryer apo që është kryer, denohet me gjobe ose me burgim gjer në tre vjet”*.

E pandehura Stelina Kuqi ka cenuar ato mërdhënie që rregullojnë punën dhe funksionimin normal të organeve të drejtësisë në veçanti dhe aparatit shtetëror në teresi. Shtetasi duhet të jenë të përgjegjshëm për zbatimin e ligjit dhe në rast se shohin ndonjë shkelje të tij janë të detyruar të njoftojnë menjëherë në organet përkatëse, përndryshe moskallezimi përben veprën penale. Këto mosveprime, për t’u cilësuar si veprën penale nga ligji, duhet që :

- të kenë prekur marrëdhëniet që rregullojnë punën dhe funksionimin normal të organeve të drejtësisë në veçanti dhe aparatit shtetëror në teresi.
- nga ana objektive kjo veprën kryhet me mosveprim. Shtetasi megjithatë vjen në dëni të një krimi, nuk e kallezon atë në organet përkatëse, megjithatë e ka për detyrë ta bëjë këtë gjë. Këto organe nuk janë vetëm organet e rendit publik apo ato të ndjekjes penale. Shtetasi është i detyruar të njoftojë çdo krim tek çdo autoritet i pushtetit vendor apo, qendror i njohur në njësine administrative ku, ky shtetas banon.
- subjekti që kryen këto veprime duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret të ketë mbushur 14 vjeç. Gjithashtu nuk duhet të jetë subjekti i parashikuar nga paragrafi i dytë i këtij neni.
- Veprimet e autorit duhet të kryhen me dashje direkte. Motivët nuk kanë rëndësi por, mbahen parasysh nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit.

Fajësia në ngarkim të të pandehurve provohet plotësisht me aktet e ndodhura në fshikullin e procedimit penal me nr. 5718, viti 2020, i cili u shqyrtua dhe u administrua në teresi nga Gjykata, pasi për këtë çështje u procedua me gjykim të shkurtuar.

Si gjatë hetimeve, ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, të pandehurit Mario Roshi, Denada Norja, Xhesika Shahu, Adriana Lika, Xhuliana Sharka dhe Stelina Kuqi kanë mbajtur qëndrim pohues, si dhe kanë treguar pendim të thellë për veprën e kryer.

Në caktimin e masës së dënimit nga gjykata mbahet parasysh rrezikshmeria shoqërore e veprës penale dhe e të pandehurve, moshë relativisht e re e të pandehurve, fakti që ata janë të padënuar me parë, si dhe pendimi i tyre i thellë për veprën e kryer.

Gjykata çmon se në caktimin e masës së dënimit për të pandehurat Denada Norja, Adriana Lika, Xhuliana Sharka dhe Stelina Kuqi, për shkak të rrezikshmerisë së paketës që paraqesim, plotësohen kriteret ligjore për kryerjen e një pune në interes publik, të

parashikuara ne nenin 63 te KP, i cili sanksionon:

“Gjykata, per shkak te rrezikshmerise se paket te personit dhe te rrethanave te kryerjes se vepres penale, kur ka caktuar nje denim gjer ne nje vit burgim, mund te vendose pezullimin e ekzekutimit te vendimit me burgim dhe zevendesimin e tij me detyrimin qe i denuari te permbushe nje pune ne interes publik.

Puna me interes publik nenkupton kryerjen nga i denuari te nje pune, me pelqimin e tij dhe pa shperblim, ne favor te interesit publik apo shoqates se caktuar ne vendimin e gjykates, per nje kohe nga dyzet deri ne dyqind e dyzet ore.

Ky detyrim nuk mund te vendoset kur i denuari refuzon pezullimin ne seance gjyqesore.

Puna ne interes publik kryhet brenda afatit prej gjashte muajsh.

Ne vendimin e saj gjykata percakton numrin e oreve te punes dhe detyrimin qe i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves. Sherbimi i proves vendos llojin e punes qe do te kryhet, percakton vendin e kryerjes se punes dhe ditet e javes kur do te kryhet ajo, duke pasur parasysh, per aq sa eshte e mundur, punesimin e rregullt te te denuarit apo detyrimet e tij familjare. Kohezgjatja e punes me interes publik nuk i kalon tete ore ne dite.

Nese i denuari nuk kryen punen me interes publik, nuk mban kontakte me sherbimin e proves apo shkel kushtet ose detyrimet e tjera, te vendosura nga gjykata, prokurori informon menjehere gjykatën. Gjykata, ne kete rast, vendos sipas nenit 62 te ketij Kodi”.

Gjykata cmon se ne caktimin e mases se denimit per te pandehuren Xhesika Shahu, per shkak te rrezikshmerise se paket qe paraqet, plotesohen kriteret ligjore per pezullimin e ekzekutimit te vendimit te denimit me burgim te parashikuara ne nenin 59 te KP, i cili sanksionon:

“Per shkak te rrezikshmerise se paket te personit, moshes, kushteve shendetesore apo mendore, menyres se jeteses apo nevojave, veçanerisht atyre qe lidhen me familjen, shkollimin ose punen, rrethanave te kryerjes se vepres penale si dhe sjelljes pas kryerjes se vepres penale gjykata kur jep denimin me burg deri ne pese vjet mund te urdheroje qe i denuari te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te vihet ne prove duke pezulluar ekzekutimin e denimit me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjeter penale”.

Pezullimi i ekzekutimit te vendimit me burgim dhe venia ne prove e autorit te vepres penale perfshihet ne kategorine e alternativave te denimit me burgim dhe synon te zgjeroje mundesite e edukimit dhe rehabilitimit ne shoqeri te personit qe ka kryer vepren penale ne forma te ndryshme nga ajo e kufizimit te lirise se tij personale.

Ne rastin konkret, Gjykata cmon se riedukimi i te pandehurave mund te realizohet pa qene e nevojshme qe ai te izolohet nga shoqeria.

PER KETO ARSYE

Gjykata, ne baze te nenit 329/b/3 dhe 390 te K.Pr.Penale

V E N D O S I

Pushimin çeshtjes penale ndaj te pandehurit Mario Roshi, per vepren penale te “Shfrytezimi i prostitucionit”, te parashikuar nga neni 114 i K.Penal.

Pushimin çeshtjes penale ndaj personit nen hetim Andi Roshi, per vepren penale te

“Mbajtja e lokaleve per prostitucion”, te parashikuar nga neni 115 i K.Penal.

Shuarjen e mases se sigurimit personal “detyrim arrest ne shtepi” te vendosur ndaj te personit nen hetim Andi Roshi me vendimin nr. 1512 Akti, date 14.09.2020 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Deklarimin fajtor te te pandehurit Mario Roshi per vepren penale te “Mbajtja e lokaleve per prostitucion” dhe ne baze te nenit 115 te Kodit Penal denimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht te te pandehurit Mario Roshi me 1 vit burgim.

Vuajtja e denimit te pandehurit Mario Roshi i fillon nga dt. 12.09.2020, dita e ndalimit te tij nga policia dhe do te vuhet ne nje burg te sigurise se zakonshme.

Deklarimin fajtor te te pandehures Denada Norja per vepren penale te “Prostitucionit” dhe ne baze te nenit 113/1 te Kodit Penal denimin e saj me 3 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht te te pandehures Denada Norja me 2 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 63 te K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim dhe zevendesimin e tij me detyrimin e te pandehures Denada Norja per te kryer 100 ore pune ne interes publik, brenda nje kohe prej 6 muajsh dhe gjate kesaj kohe te mbaje kontakte me sherbimin e proves.

Deklarimin fajtor te te pandehures Xhesika Shahu per vepren penale te “Prostitucionit” dhe ne baze te nenit 113/1 te Kodit Penal denimin e saj me 3 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht te te pandehures Xhesika Shahu me 2 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 59/3 te K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te ketij vendimi, me kusht qe gjate 4 muajve, duke filluar nga e nesermja e shpalljes se vendimit, e pandehura Xhesika Shahu te mos kryeje veper tjeter penale dhe gjate kesaj kohe te mbaje kontakte me Zyren Vendore te Sherbimit te Proves, Tirane.

Urdherohet e pandehura Xhesika Shahu qe gjate kohes se proves prej 4 muajsh, ne baze te pikes 9 te nenit 60 te K.Penal, te mos shoqerohet me persona te denuar.

Deklarimin fajtor te te pandehures Adriana Lika per vepren penale te “Prostitucionit” dhe ne baze te nenit 113/1 te Kodit Penal denimin e saj me 3 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht te te pandehures Adriana Lika me 2 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 63 te K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim dhe zevendesimin e tij me detyrimin e te pandehures Adriana Lika per te kryer 100 ore pune ne interes publik, brenda nje kohe prej 6 muajsh dhe gjate kesaj kohe te mbaje kontakte me sherbimin e proves.

Deklarimin fajtor te te pandehures Xhuliana Sharka per vepren penale te “Prostitucionit” dhe ne baze te nenit 113/1 te Kodit Penal denimin e saj me 3 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht te te pandehures Xhuliana Sharka me 2 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 63 te K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim dhe zevendesimin e tij me detyrimin e te pandehures Xhuliana Sharka per te kryer 100 ore pune ne interes publik, brenda nje kohe prej 6 muajsh dhe gjate kesaj kohe te mbaje kontakte me sherbimin e proves.

Deklarimin fajtores te te pandehures Stelina Kuqi per vepren penale te "Moskalleziom i krimi" dhe ne baze te nenit 300 te Kodit Penal denimin e saj me 3 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 406 te K.Pr.Penale, uljen e 1/3 se ketij denimi dhe denimin perfundimisht te te pandehures Stelina Kuqi me 2 muaj burgim.

Ne zbatim te nenit 63 te K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim dhe zevendesimin e tij me detyrimin e te pandehures Stelina Kuqi per te kryer 100 ore pune ne interes publik, brenda nje kohe prej 6 muajsh dhe gjate kesaj kohe te mbaje kontakte me sherbimin e proves.

Nje kopje e ketij vendimi t'i dergohet Zyres Vendore te Sherbimit te Proves Tirane.

Shpenzimet procedurale i ngarkohen te pandehurve.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane brenda 15 diteve nga e nesermja e njoftimit te vendimit.

U shpall sot, me 16.06.2021.

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R

ETLEVA AVDIA

KRESHNIK OMARI

Shpenzimet procedurale te Prokurorise

6 000 leke

Shpenzimet gjyqesore

Njoftime

1200 leke